

16.05.2022

*[Handwritten signature]*



BAS...AM/...  
Z...  
Nr. 2709...  
Date: 16.05.2022...  
*[Handwritten signature]*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE**

Korçë, me 11.05.2022

**SHPLLJE VENDIMI**

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: Elsona Dervishaj me adrese Pirg Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 272 dt. 10.04.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " e panjohur... " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

**KANCELARE  
Lubiana KINOLLI**



U afishua ne Bashkine Maliq

Nenpunesi \_\_\_\_\_

(emer, mbiemer, firme)

*Pr. 58 Prist  
Dt. 17.05.2022*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇË

Nr.Regj.Them 21017-00590-41-2022 (34 UM)  
Dt.Regj 08.04.2022

Nr.Vendimi 41-2022-1075 (272)  
Dt.Vendimi 10.04.2022

VENDIM  
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe e perbere nga  
**GJYQTAR: ARBEN LERA**

Asistuar nga sekretare gjyqesore Xhorxhina Vangjel, ne Korçe sot me daten 10.04.2022, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile me Nr.regj.them 21017-00590-41-2022 (34 UM), Dt. Regj 08.04.2022 qe i perket:

**PADITËSE: Elsona Dervishaj**, e bija e Petraq dhe Pranvera, e dtl.02.10.2000, banuese ne fshatin Pirg, Korçe, me arsim 8-klase, me gjendje civile e martuar, identifikuar me karte identiteti nr. ...137.

**I PADITUR: Maldin Maxhari**, i biri i Murat dhe Artjona, i dtl. 10.10.1997, banues në Pogradec, Lagj. Nr.4, Rruga e Kalase, me gjendje civile i martuar, identifikuar me karte identiteti nr. ...131.

**OBJEKTI:** Lëshimin e urdhërit të menjëhershëm te mbrojtjes.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar.

Pas verifikimit te prezences te paleve, **paditesja Elsona Dervishaj** deklaroi se heq dore nga gjykimi i padise dhe kerkoi pushimin e gjykimit.

**I padituri Maldin Maxhari**, u shpreh dakord me kerkesen e paditeses.

Gjykata pasi degjoi kerkesen e paditeses Elsona Dervishaj

**PARASHTRON:**

Me kerkese padine drejtuar Gjykates te Rrethit Gjyqesor Korçe paditesja Elsona Dervishaj ka kerkuar leshimin e urdherit te menjehershem te mbrojtjes ndaj bashkeshortit te saj Maldin Maxhari, pasi pretendon se ai ka ushtruar dhune psikologjike ndaj saj, mbeshtetur ne Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar.

Referuar objektit të padisë, gjykata caktoi seancën gjyqesore në përputhje me rregullimin e parashikuar në nenin 18, pika 1 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, sipas të cilit, gjykata ka



detyrimin të vendose në lidhje me kërkesën brenda 24 oreve nga parashtrimi i saj, kur i/e dhunuara është i/e mitur dhe brenda 48 orëve kur i/e dhunuari/a është madhor/e. Meqenese palet jane madhore, gjykata planifikoi seancën brenda 48 orëve nga paraqitja e padisë.

Sipas nenit 9 dhe nenit 12, pika 1 të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunes në marrëdhëniet familjare”, Gjkata e Rrethit Gjyqesor Korçë, është kompetente për të shqyrtuar padinë, si nga pikëpamja lëndore dhe ajo tokësore, pasi është gjykata e vendbanimit zyrtar të viktimës dhe dhunuesit (*paditesja eshte me banim në fshatin Pirc, Korçe*).

Gjkata, çmon se paditesja legjitimohet ne ngritjen e kesaj kerkesepadie pasi eshte nje prej subjekteve qe mbrohet nga ligji nr. 9669 date 18.12.2006 “Per masat ndaj dhunes ne marredheniet familjare” i ndryshuar, neni 3/3 duke pretenduar se ajo eshte objekt i dhunes ne familje.

Padia e saj eshte ngritur kunder personit qe ajo pretendon se e ka dhunuar, bashkeshortit te saj ne baze te nenit 3/5 te ligjit te sipercituar.

Referuar objektit te padise, gjykata caktoi seancen gjyqesore ne perputhje me rregullimin e parashikuar ne nenin 18 te pika 1 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006. Seanca gjyqesore per leshimin e urdherit te menjehershëm te mbrojtjes u caktua ne dt. 10.04.2022, ora 10<sup>00</sup>.

Ne seancen gjyqesore te kesaj date u paraqiten te dyja palet ndergjyqese, ku pas verifikimit te prezences se tyre ne momentin procedural te paraqitjes te kerkesave paraprake paditesja Elsona Dervishaj, deklaroi se heq dore nga gjykimi i padise dhe kerkoi pushimin e gjykimit, duke u shprehur qe do te komunikojë me te paditurin vetem per menyren e takimit me femijen e mitur.

Bazuar ne nenin 201 te K.Pr.Civile, Gjkata mori mendimin e te paditurit Maldin Maxhari i cili deklaroi se eshte dakort me kerkesen e paditeses Elsona Dervishaj per heqjen dore nga kerkesa duke u shprehur se nuk do ti krijojë shqetesime paditeses dhe do te komunikojë vetem per ceshtjen e femijes.

Ne keto kushte referuar nenit 299/c te K.Pr.Civile ku parashikohet se: “Gjkata vendos pushimin e gjykimit kur: c) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht ne ligj”, gjykata çmon se duhet te vendose pushimin e gjykimit.

Ne rastin konkret pushimi i gjykimit per shkak te heqjes dore nga gjykimi parashikohet ne nenin 201 te K.Pr.Civile ku citohet se: “Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i paditurie pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes.

*Gjkata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm”.*

***Perfundimisht, ne kushtet kur rezulton qe paditesja Elsona Dervishaj deklaroi se heq dore nga gjykimi i padise, Gjkata bazuar ne dispoziten e sipercituar ka detyrimin ligjor qe te disponoje me vendim per pushimin e gjykimit te ceshtjes.***

#### **PER KETO ARSYE**

Gjkata, bazuar në nenet 201/1 dhe 299/c te K.Pr.Civile




VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes civile me Nr.regj.them 21017-00590-41-2022 (34 UM), Dt. Regj 08.04.2022 me pale paditese Elsona Dervishaj, i paditur Maldin Maxhari, me objekt leshimin e urdherit të menjehershëm të mbrojtjes.
- Shpenzime gjyqesore nuk u evidentuan.
- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pese) diteve duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot më datë 10.04.2022, ora 11<sup>00</sup>.

**SEKRETARE**  
Xhorxhina VANGJEL



**GJYQITAR**  
Arben LERA

